

Nr. Prot. 069/B/20

VENDIM Nr. 1666

Për

**Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të
'Draft Rregullore për Planin Kombëtar të Numeracionit
për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës'**

Në mbështetje të neneve; nenit 3, paragrafi 1), nenit 10, paragrafët 4), 11) dhe 12), nenit 79, paragrafët 1) dhe 2), nenit 82, paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*); në referim të nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Bahri Anadolu, Anëtar
- 2) z. Hazir Hajdaraj, Anëtar
- 3) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 4) z. Shqiprim Pula, Anëtar

në mbledhjen e 58-të me radhë të mbajtur më datë 27 Nëntor 2020, pas shqyrtimit të materialit të përparuar nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), nxjerr këtë;

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të dokumentit '**Draft Rregullore për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës**'.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë; **29 Dhjetor, 2020** dhe përfundon më **28 Janar, 2021**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: "*Miratohet legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.*"

Më tutje, neni 10, paragrafët 11) dhe 12) të Ligjit përkufizojnë kompetencat e Autoritetit për miratimin e Planit Kombëtar të Numeracionit dhe menaxhimin e resurseve numerike në komunikimet elektronike.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Ndryshimet në Planin e ri të Numeracionit janë vlerësuar të nevojshme nga Autoriteti me qëllim të qartësimin të mëtutjeshëm të procedurave administrative, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e resurseve numerike nga ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike si dhe shfrytëzuesit tjerë, si dhe harmonizimin me dokumentet e Bashkimit Europian.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike;

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 29/12/2020

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Aktvendimi i dërgohet;

- Operatorëve (ndërmarrësve) të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Departamentit Ligjor (DL),
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE),
- Arkivës së Autoritetit.